

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M. Sh., nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati B. J., nga ..., kundër të paditurës KS “D.” në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson A. L., objekti i kontestit shpërblimi i dëmit, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësit av. B. J., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2246/2014 datë 21.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.6.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit M. Sh., av. B. J., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2246/2014 datë 21.12.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e goditur të gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2246/2014 datë 21.12.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2645/09 datë 6.12.2013 me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura KS “D.” që në emër të shpërblimit të dëmit për shpenzimet e shërimit të paditësit, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 23.250 €, me kamatë të rregullt në lartësi të cilat i pranojnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, kamatën ndëshkuese në lartësi të kamatave ndëshkuese që aplikojnë bankat komerciale si dhe të paguaj shpenzimet procedurale. Është vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi në afat ligjor ka paraqitur revizion duke goditur të njëjtën, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizion, me propozim që revizioni i paditësit të refuzohet dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, sipas nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë vërtetohet se e paditura paditësit ia ka lëshuar policën për sigurim të shëndetit të udhëtimit me nr. ..., të datës 29.4.2009 dhe se kjo policë ka qenë e vlefshme për periodën prej 9.4.2009 e deri më 8.8.2009. Paditësi gjatë kohës sa ka pasur policën e sigurimit është sëmure rëndë ashtu që nga autoritetet e Zvicrës ka kërkuar ndihmë dhe është dashtë të bëjë një trajtim të detyrueshëm mjekësor për çka ka pasur shpenzime për shërim në shumë prej 23.250 €, të cilat paditësi konsideron se duhet të mbulohen nga polica e sigurimit.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provën me ekspertë mjekësorë dr. Bekim Dula, kardiokirurg, i cili në bazë të dokumentacionit që posedon paditësi, ka konstatuar se sëmundja e cila është shfaqur te paditësi gjatë mbërritjes në Zvicër, është sëmundje e cila ka ekzistuar edhe më herët dhe kjo nuk është e mbuluar me policën e sigurimit. Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar rreziku nuk është mbuluar me policën e sigurimit në kuptim të nenit 398 par. 1 dhe 2 të LMD-së, refuzoi kërkesëpadinë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të njëjtën ka refuzuar duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Aktgjykimi i goditur sipas vlerësimit të kësaj Gjykate përmban arsye të mjaftuara për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e kësaj çështjeje juridike të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit të paditësit se gjykata e shkallës së parë ka interpretuar në mënyrë të gabueshme dispozitën e nenit 396 par. 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr. 29/78 e cila ka qenë e aplikueshme nga arsyeja se me nenin 398 par. 1 është definuar rreziku i siguruar. Rreziku që është përfshirë në sigurim duhet të jetë i ardhshëm, i pasigurte dhe i pavarur nga vullneti i kontraktuesve. Rreziku i siguruar është element qenësor i kontratës së sigurimit. Përndryshe, ky është rreziku i mbuluar me kontratë të sigurimit. Me këtë kontratë siguroesi merr përsipër bartjen e pasojave shkaktuar nga rasti i siguruar dhe se rasti i siguruar duhet të ekzistojë pas lidhjes së kontratës së sigurimit. Nga raporti i ekspertit dr. B. D., dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ana e paditësit, vërtetohet se sëmundja e cila është shfaqur paditësit gjatë udhëtimit jashtë vendit, përkatësisht në Zvicër, ka të bëjë me të njëjtën sëmundje për të cilën ka pasur probleme në të kaluarën dhe për të njëjtën është trajtuar më herët, çka nënkupton se paditësi ka pasur probleme shëndetësore edhe në të kaluarën, dhe se paditësi paraprakisht ka pasur infarkt, nga kjo del konstatimi se sëmundja e paditësit ka ekzistuar edhe më parë.

Thëniet e tjera të revizionit nuk janë vlerësuar pasi që të njëjtat kanë të bëjnë me gjendjen e vërtetuar faktike, për të cilin shkak në bazë të nenit 214.2 revizioni nuk mund të paraqitet.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.184/2019 datë 12.6.2019

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri